



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË	UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË	
REKTORATI			
Nr. / Br. / No. <u>870</u>		Nr. i faq/ Br. str / No. pg <u>8</u>	
Data / Datum / Date: <u>04.04.2024</u> Pejë - Peë			

RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN E PUNËS SË INSTITUTIT PËR SHKENCË DHE ARTE

Pejë, 2024

Në bazë të nenit 28 të Statutit të Institutit për Shkencë dhe Arte të UHZ nr. 249/23, të datës 07.02.2023, Këshilli Drejtues i ISHA-së në mbledhjen e mbajtur më dt. 03.04.2023, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN E PUNËS SË INSTITUTIT PËR SHKENCË DHE ARTE

QËLLIMI

Neni 1

Instituti për Shkencë dhe Arte në Universitetin "Haxhi Zeka" ka për qëllim rritjen, përhapjen dhe mbrojtjen e shkencës; ai promovon dhe zbaton projekte kërkimore shkencore duke bashkëpunuar me akademi, universitete, organizata dhe Qendra Kërkimore, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 2

1. Me këtë Rregullore përcaktohet organizimi i punës në Institutin për shkencë dhe arte (në vijim referuar si ISHA), të drejtat dhe detyrimet e të punësuarve, kontrata e punës, pagat, dhe procedurën dhe masat për mbrojtjen e dinjitetit të punonjësve.
2. Rregullorja zbatohet drejtpërdrejt për të gjithë të punësuarit, nëse të drejtat dhe detyrimet e një punonjësi individual nuk janë të rregulluara në mënyrë më të favorshme me kontratën e punës apo kontratën kolektive.
3. Nëse një Kontratë kolektive që e detyron Institutin (në tekstin e mëtejshëm: Kontrata Kolektive) rregullon një çështje individuale nga marrëdhënia e punës në mënyrë më të favorshme për një të punësuar sesa të drejtat që parasheh kjo Rregullore, dispozitat e Kontratës Kolektive do të zbatohen drejtpërdrejt dhe kanë përparësi në zbatim.
4. Për çështjet që nuk janë paraparë me këtë rregullore, zbatohen dispozitat e "ISHA-së") dhe akteve tjera juridike brenda UHZ-së.

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E PERSONELIT TË ISHA-së

Neni 3

Çdo punëtor i punësuar në Instituti është i detyruar me kontratën e punës t'i kryejë detyrat e marra brenda afatit, me ndërgjegje dhe profesionalizëm, sipas udhëzimeve të Institutit, në përputhje me natyrën dhe llojin e punës.

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E ISHA-së

Neni 4

Instituti, si punëdhënës, dhe punëmarrësi janë të detyruar të respektojnë, përveç përcaktimeve të kontratës së punës, ligjet dhe kontratat kolektive që zbatohen për institutet shkencore publike dhe dispozitave të kësaj rregulloreje.

AKTIVITETET KËRKIMORE-SHKENCORE DHE ARTISTIKE

Neni 5

Veprimtaria e ISHA-së është e përqendruar në aktivitete kërkimore-shkencore dhe artistike.

Neni 6

Veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe artistike ISHA e realizon nëpërmjet aktiviteteve si në vijim:

- a) Realizimin e aktiviteteve kërkimore-shkencore dhe artistike në fushën e shkencave të biznesit, ekonomisë, financave dhe teknologjisë informative; turizmit dhe hotelerisë; drejtësisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare; agrobiznesit dhe mjedisit; dhe shkencave artistike –muzikore;
- b) Realizimi i projekteve kërkimore-shkencore dhe artistike në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar;
- c) Organizimi i tryezave të rumbullakëta, punëtorive, seminareve dhe konferencave kërkimore-shkencore dhe artistike;
- d) Realizimi i bashkëpunimeve me akademi, universitete, organizata dhe Qendra Kërkimore, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
- e) Bashkëpunimi me institute kombëtare dhe ndërkombëtare;
- f) Organizimi i trajnimeve në fushën e hartimit të projekteve kërkimore-shkencore dhe artistike;
- g) Organizimi i trajnimeve në fushën e përdorimit të programeve softuerikë.

Neni 7

Veprimtaria kërkimore-shkencore dhe artistike e Institutit është e organizuar nëpërmjet njësive akademike të UHZ-së të përfaqësuara në Institut:

- 1) Njësia e Institutit – Fakulteti i Biznesit;
- 2) Njësia e Institutit – Fakulteti i Menaxhimit të Turizmit, Hotelerisë dhe Mjedisit;
- 3) Njësia e Institutit – Fakulteti Juridik;
- 4) Njësia e Institutit – Fakulteti i Agrobiznesit;
- 5) Njësia e Institutit – Fakulteti i Arteve.

Neni 8

1. Punën e njësive të veçanta të Institutit e koordinon prodekani për shkencë i secilës njësi të veçantë.
2. Njësitë e Instituteve kanë nga 3 anëtarë, të emëruar nga Këshilli i fakultetit;
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e këtyre anëtarëve përcaktohen me rregullore të veçantë të hartuar nga Këshilli shkencor.

Neni 9

1. Koordinator i projektit të caktuar në kuadër të ISHA emërohet nga ana e Këshillit Shkencor me propozim të drejtorit të Institutit.
2. Koordinator i projektit menaxhon projektin sipas marrëveshjes së caktuar për realizimin dhe financimin e të njëjtit.
3. Koordinator i projektit është përgjegjës për realizimin e detyrave të ekipit kërkimor, individëve dhe pjesëmarrësve në projekt.

Neni 10

Rezultatet e aktivitetit kërkimor të ISHA janë të qasshme për publikun në ueb faqen zyrtare të universitetit.

Neni 11

1. Anëtarët e ekipit hulumtues marrin kompensim në të holla në pajtim me mjetet e përcaktuara financiare të projektit dhe aktet e brendshme të ISHA.
2. Drejtori i Institutit e miraton pagesën e kompensimeve sipas dinamikës së projektit dhe procedurave të brendshme të ISHA.

NDALIM I DISKRIMINIMIT

Neni 12

1. Diskriminimi është i ndaluar në punësim dhe profesion, lidhur me rekrutimin në punësim, trajnim, promovimin e punësimit, kushtet e punësimit, masat disiplinore, ndërprerjen e kontratës së punës, anëtarësimi në sindikatë ose çështjeve të tjera nga marrëdhënia e punës të rregulluara me legjislacionin në fuqi.
2. Ndalohet diskriminimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i personave me aftësi të kufizuara gjatë punësimit, avancimit në punë dhe avancimit profesional, nëse për atë vend pune është i aftë ta kryejë punën në mënyrë adekuate, ashtu siç parashihet me Ligjin e Punës Ligji Nr. 03/L-212.

MBROJTJA E DINJITETIT TË PUNËTORIT

Neni 13

1. Instituti është i detyruar të mbrojë dinjitetin e punëtorëve gjatë punës, që përfshin marrjen e masave parandaluese. Dinjiteti i punëtorit mbrohet nga ngacmimi verbal ose ngacmimi seksual nga bashkëpunëtorët, eprorët dhe personat me të cilët punëtori bie rregullisht në kontakt gjatë kryerjes së detyrës.
2. Ndalohet çdo sjellje e padëshiruar e cila synon ose paraqet në fakt cenimin e dinjitetit të një personi që kërkon punë ose punëtor dhe që shkakton frikë ose një mjedis armiqësor, poshtërues ose fytes.
3. Diskriminimi përfaqësohet edhe nga ngacmimi seksual, që nënkupton çdo sjellje verbale, jo verbale ose fizike të natyrës seksuale, e cila synohet ose paraqet në fakt cenim të dinjitetit të një personi që kërkon punësim dhe që shkakton frikë ose një sjellje armiqësore, poshtëruese ose mjedis fytes.
4. Punëtori që mendon se i është cenuar dinjiteti nga ngacmimet ose ngacmimet seksuale, ka të drejtë të paraqes rastin tek Drejtori i Institutit.
5. Drejtor i Institutit pas pranimit të ankesës duhet menjëherë, jo më vonë se 8 ditë të paraqes rastin në Këshillin e Etikës së Institutit.
6. Këshilli i Etikës duhet të zhvillojë procedurë për trajtimin e rastit dhe të vendos për ankesën e paraqitur.
7. Rasti i ngacmimit seksual duhet të paraqitet tek organet e rendit në Republikën e Kosovës.
8. Të gjitha të dhënat e përcaktuara në procedurën për mbrojtjen e dinjitetit të punëtorëve janë sekrete dhe shkelja e tyre përbën shkelje të detyrimit të punës.

MBROJTJA E PRIVATËSISË SË PUNËTORËVE

Neni 14

1. Punëtorët janë të detyruar t'i paraqesin Institutit të gjitha të dhënat personale të përcaktuara me rregulloret për evidencën në fushën e punës, dhe për të ushtruar të drejtat dhe detyrimet e tyre nga marrëdhënia e punës dhe të dhënat: për llogaritjen e tatimit mbi të ardhurat dhe përcaktimin e zbritjeve personale, të dhënat mbi edukimin dhe njohuritë e caktuara specialistike, gjendjen shëndetësore dhe shkallën e aftësisë së kufizuar, për ndalimin kontraktual të konkurrencës me punëdhënësin e mëparshëm, të dhëna lidhur me mbrojtjen e lehonisë.
2. Të dhënat e ndryshuara duhet t'i dorëzohen në kohën e duhur një personi të autorizuar në Institut. Të gjitha të dhënat që mbledhen ose mbahen për punëtorët janë konfidenciale dhe mund të përdoren vetëm për qëllimet e Institutit.
3. Të dhënat u jepen dhe përdoren vetëm nga ato palë të treta që janë të autorizuar për ta bërë këtë bazuar në rregulloret në fuqi në Institut. Të dhënat mund t'u jepen personave të tjerë vetëm me kërkesë dhe miratim me shkrim të punëtorit.

4. Drejtori i Institutit cakton një person i cili përveç tij është i autorizuar të mbledhë të dhëna personale për punëtorët, t'i përdorë dhe t'ua dorëzojë palëve të treta.

NDALIMI I KONKURRENCËS SË PUNËTORIT ME PUNËDHENËSIN

Neni 15

1. Punëtori pa miratimin e Institutit nuk mund të hyjë në biznes në lidhje me veprimtaritë që kryen Instituti, për llogari të tij ose të dikujt tjetër dhe as nuk mund të jetë pronar i një aksioni. në një shoqëri që ushtron biznes në lidhje me veprimtarinë e Institutit.
2. Nëse punëtori vepron në kundërshtim me ndalimin nga paragrafi 1 i këtij neni, Instituti mund t'i kërkojë punëtorit kompensim për dëmin e pësuar ose mund të kërkojë që puna e përfunduar të konsiderohet e përfunduar për llogari të tij, gjegjësisht që punëtori të dorëzojë. fitimet nga një punë e fillë ose t'ia transferojë pretendimin atij fitimet nga kjo punë.
3. Punëdhënësi mund të revokojë miratimin nga paragrafi 1 i këtij neni, duke respektuar afatin e përcaktuar ose të rënë dakord për zgjidhjen e kontratës së punës, përkatësisht duke respektuar afatin e arsyeshëm për ndërprerjen e bashkëpunimit të miratuar nga paragrafi 1 i këtij neni.
4. Instituti dhe punëtori mund të bien dakord që për një periudhë të caktuar pas përfundimit të kontratës së punës, punëtori të mos punësohet nga një person tjetër, i cili është në konkurrencë tregu me Institutin dhe nuk mundet për llogari të tij, ose për llogari të një të treti, të hyjë në biznes me të cilin konkurren me Institutin.

MARRËDHËNIA E PUNËS

Neni 16

1. Marrëdhënia e punës bazohet në kontratë pune.
2. Kontrata e rregullt e punës mund të lidhet për:
 - një periudhë të pacaktuar;
 - një periudhë të caktuar.
3. Kontrata e punës mund të lidhet edhe për punë dhe detyra specifike (kontratë mbi veprën; marrëveshje për shërbime të veçanta).
4. Kontrata e punës lidhet me shkrim dhe duhet të përmbajë dispozitat e përcaktuara me ligj.

PAGA, KOMPENSIMI I PAGËS DHE TË DREJTA TË TJERA MATERIALE

Neni 17

1. Punëtori ka të drejtë në pagë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e brendshme të Institutit.

2. Paga bazë përcaktohet për pozitat individuale në përputhje me rregullat nga paragrafi 1 i këtij neni, duke shumëzuar bazën dhe koeficientin e kompleksitetit të punëve dhe detyrave.
3. Shtesat në pagën bazë: stimulimet, shtesat për kushte të veçanta të punës, shtesat e pozitës, rritja e pagës etj., përcaktohen me rregullore të veçantë të Institutit.
4. Me rastin e lidhjes së kontratës së punës, me vendim të veçantë, të cilin e merr drejtori i Institutit, caktohet paga e punëtorit, në pajtim me dispozitat nga paragrafi 1 i këtij neni.

ORARI I PUNËS

Neni 18

1. Orari i rregullt i punës është nga ora 8:00 deri në 16:00, nga e hëna deri të premten.
2. Drejtori i Institutit mund të përcaktojë orar fleksibil të punës në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë në punë.
3. Orari i punës caktohet nga Drejtori dhe publikohet një javë para fillimit.
4. Puna jashtë orarit të rregullt paguhet në përputhje me dispozitat e Ligjit të Punës në Kosovë (LIGJI Nr. 03/L-212).

PUSHIMET NGA PUNA

Neni 19

Instituti zbaton në përpikëri dispozitat e Ligjit të Punës në Kosovë (Ligji Nr. 03/L-212) për të gjitha llojet e pushimeve dhe mungesave nga puna.

PËRFUNDIMI I KONTRATËS SË PUNËS

Neni 20

1. Kontrata e Punës sipas fuqisë ligjore, ndërpritet:
 - a) Me vdekjen e të punësuarit;
 - b) Me vdekjen e punëdhënësit, kur puna e kryer apo shërbimet e ofruara nga punëtori janë të natyrës personale, atëherë kur kontrata nuk mund të vazhdohet me pasardhësit e punëdhënësit;
 - c) Me skadimin e kohëzgjatjes së kontratës;
 - d) Kur i punësuarit e mbush moshën e pensionimit, prej gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç;
 - e) Në ditën e dorëzimit të aktvendimit të plotfuqishëm për vërtetimin e humbjes së aftësive për punë;
 - f) Nëse i punësuarit shkon në vuajtje të dënimit i cili do të zgjasë më tepër se gjashtë (6) muaj;
 - g) Me vendimin e gjykatës kompetente, vendim që pason ndërprerjen e marrëdhënies së punës;

- h) Me mbylljen e Institutit;
 - i) Rastet e tjera të përcaktuar sipas ligjeve në fuqi.
2. Kontrata e Punës mund të ndërpritet me marrëveshje ndërmjet punëdhënësit dhe të punësuarit.
 3. I punësuarit ka të drejtën e ndërprerjes së Kontratës së Punës në mënyrë të njëanshme.
 4. I punësuarit me kontratë në kohë të caktuar për ndërprerjen e kontratës së punës, duhet ta informojë punëdhënësin paraprakisht në formë të shkruar në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, ndërsa i punësuarit me kontratë në kohë të pacaktuar në afatin prej tridhjetë (30) ditësh.
 5. Punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit me një periudhë paralajmërimi, atëherë kur:
 - a) Ndërprerja e fillë arsyetohet për arsye ekonomike, teknike ose organizative;
 - b) I punësuarit nuk është më i aftë t'i kryejë detyrat e punës;
 - c) Punëdhënësi mund ta ndërpresë kontratën e punës në rrethanat e përcaktuara në nën paragrafin 1. dhe 2., të këtij paragrafi nëse është e papërshtatshme për punëdhënësin që ta transferojë të punësuarin në një vend pune tjetër, ta trajtojë a ta kualifikojë atë për ta kryer punën ose ndonjë punë tjetër;
 - d) Punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit në periudhën e kërkuar të paralajmërimit të ndërprerjes në:
 - a. Rastet e rënda të sjelljes së keqe të punonjësit; dhe
 - b. Për shkak të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 21

Dispozitat e Statutit dhe aktet tjera të ISHA, me të cilat rregullohet aktiviteti kërkimor – shkencor dhe artistik zbatohen në mënyrë gjegjëse në funksionimin e Institutit.

Neni 22

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i ISHA-së.

Kryesues i Këshillit Drejtues të ISHA-së

Prof. Dr. Armand Krasniqi

